



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 8445/2 Prot

Fier më, 22.07/2026

PROCESVERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 22.07.2026. Sot në sallën e mbledhjeve ora 10:00. Të pranishëm në mbledhje 29 këshilltarë.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Siç keni marrë njoftimin, në datë 20. 07. 2026 zhvillojmë mbledhjen jashtë radhe. Në radhë të parë, në emër të kryesisë ju kërkojë ndjesë për këtë mbledhje të zhvilluar papritur, jashtë radhe, duke mos zbatuar afatet kohore, por që është për shkak të emergjencës së dy projektvendimeve që janë paraqitur në rendin e ditës. Para se të fillojmë me rendin e ditës, zgjedhim 3 anëtarë të këshillit që do të firmosin procesverbalin: Marjus?

Z. Marius Voja

Unë vetë.

Z.Melsi Bogdani

Marius Voja. Rrapi?

Z.Rrapi Gjika

Ilia Fili

Z.Melsi Bogdani

Marius, edhe një tjetër.

Z.Marius Voja

Elvi Daka.

Z.Melsi Bogdani

Elvi Daka.Ok. Para se të hedhim rendin e ditës në votim, kemi një... kemi një pikë për të shtuar: Ekipi i vajzave të qytetit tonë militon në Champions League dhe, jashtë rendit të ditës, ne duam të fusim një shpërblim, të na sqaroi të lutem, nënkryetari, meqenëse ato janë në aktivitet e sipër. Para se të kalojmë në rendin e ditës.

Z.Agron Frofka

Ç'farë ekipi është? Futbolli apo volejbolli?

Z.Nustret Avdullaj

Futbolli. Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Meqë është një rast i veçantë, ekipi i vajzave të futbollit merr pjesë në Champions League dhe aktiviteti fillon në gusht. Duke qenë në limite , mbase do të shkelim edhe pak rregullin, por duke qenë një rast shumë i veçantë për qytetin tonë, mendoj që të akordojmë një fond për ekipin e futbollit të vajzave. Dhe, për sqarim të mëtejshëm, janë takimet me ekipe të ndryshme dhe kush nuk kualifikohet në Champions League kalon në Europa League. Pra, aktiviteti vazhdon dhe besoj që është nder për qytetin tonë të arrijë këto nivele. Këtë e them edhe si sportist, por edhe si dashamirës i futbollit.

Z.Melsi Bogdani

Kush është dakord me rendin e ditës bashkë me shpërblimin për vajzat e Apolonisë? Të gjithë dakord, faleminderit.

Pro 29 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kalojmë në miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 25.06.2026.
3. Projektvendim Nr.71 datë 14.07.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2026"
4. Projektvendim Nr.70, datë 10.07.2026 "Për miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Fier për periudhën 2026-2029"
5. Projektvendim Nr.69, datë 10.07.2026 "Për miratimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve 2026-2036 të Bashkisë Fier"
6. Informacion: "Për Raportin e Performancës së Bashkisë Fier, Viti 2025"



Z.Melsi Bogdani

Të gjithë dakord, besoj?

Znj.Antoneta Çunaj

Po.

Pro 29 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit, datë 25. 06. 2026.

Z.Melsi Bogdani

Sekretar?

Z.Armando Çupa

Atëherë, si zakonisht, procesverbali është shpërndarë nëpërmjet email-it të gjithë kryetarëve të grupeve dhe përfaqësuesve që janë caktuar nga ana juaj për të firmosur. Është firmosur pa kontestim dhe çdo gjë është në rregull.

Z.Melsi Bogdani

E hedhim në votë procesverbalin. Kush është dakord? Të gjithë dakord? Miratohet.

Pro 29 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës.

Projektvendim Nr. 71, datë 14.07.2026, "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin qershor 2026".

Z.Melsi Bogdani

Në mungesë të Mirenës, ka ndonjëri 2 fjalë të thotë sot nga ekzekutivi? Ka ndonjë shtesë? Ka ndonjë... në qoftë se s'ka. ..

Z.Elvi Daka

Është e qartë.

Z.Antoneta Çunaj

E qartë.

Z.Melsi Bogdani

E hedhim në votë. Kush është dakord? Të gjithë pro? Miratohet.

Pro 29 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projektvendim Nr. 70, datë 10. 07. 2026, "Për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Fier për periudhën 2026-2029".

Z.Melsi Bogdani

Kush do ta relatojë këtë me dy fjalë? Eleni, të lutem.

Znj.Eleni Gjirkondaj

Atëherë, përshëndetje.

Z.Melsi Bogdani

Sa më shkurt, që të mos zgjasë, dy konkludime për ndonjë...

Z.Iliria Fili

Kryetar, a ka mundësi të ndërhyjë një sekondë?

Z.Melsi Bogdani


Po, Eleni një sekondë.

Z.Iliria Fili

Më fal, kërkojë ndjesë se...që të ndërpreva fjalën. Ne e dimë që vitin që vjen janë zgjedhje lokale. Tashi i takon këtij këshilli të miratoj një program deri në 2029?

Z.Melsi Bogdani

Ja të na sqaroi, inxhinier.



Z.Ilia Fili


Sikur nuk shkon kjo punë, do duket se do... kjo punë do të përsëritet prapë. Kur të hyjë këshill i ri, gjëja e parë që do të bëjë, do bëjë pikërisht këtë gjë.

Z.Melsi Bogdani

Prandaj, ja dhashë fjalën për të na sqaruar. Shumë faleminderit.

Znj.Eleni Gjikonaj

Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Dhe ju faleminderit për pjesëmarrjen në mbledhjen e sotme, edhe për këtë mbledhje jashtë radhe. Atëherë, çfarë është plani? Unë do të sqaroj shkurtësisht çfarë është plani i integritetit, pse është i nevojshëm plani i integritetit i hartuar nga Bashkia Fier dhe nga Grupi i Punës, lidhjet që ka ndërmjet integritetit institucional dhe integritetit në tërësi, parimet e planit të integritetit, cikli i menaxhimit të integritetit, fushat e zbatimit të planit të integritetit, parimet e metodologjisë, burimet e informacionit për hartimin e këtij plani, identifikimi i rreziqeve, procesi i vlerësimit dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm. Duke thënë nga pak fjalë, do kuptoni deri në fund që pse është domosdoshëm ky plan dhe pse i shtrijmë kufijtë në 4 vite ose 5 vite. Çdo plan që hartohet, në fakt, nuk hartohet në më pak se 3 vite, dhe shërben për përmirësimin e punës së secilit. Nuk është një plan që mbyllet aty, se mbyllet viti zgjedhor, ose mbyllet mandati i këshilli bashkiak, ose... pra, i shtrijnë efektet e saj për të përmirësuar punën dhe rritur performancën e Bashkisë Fier. Atëherë, Bashkia Fier e konsideron integritetin institucional si një nga shtyllat themelore të qeverisjes së mirë dhe parakusht për garantimin e ligjshmërisë, transparencës, të vlefshmërisë dhe ushtrimin e funksioneve të saj. Qëllimi i saj është: të forcojë kuadrin e brendshëm rregullator, të zhvillojë kapacitetet profesionale të administratës, të rritë transparencën, llogaridhënien dhe komunikimin, të përmirësojë sistemin e kontrollit të brendshëm, të promovojë një kulturë organizative, të bazuar në integritet etik dhe profesionalizëm. Integriteti institucional dhe rëndësia e planit të integritetit institucional. Qëllimi i planit të integritetit është krijimi dhe konsolidimi i një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit institucional, i cili mbështetet në ushtrimin e funksioneve publike në përputhje me parimet e ligjshmërisë, etikës, transparencës, llogaridhënies, interesit publik. Cilat janë objektivat e këtij plani? Janë objektiva të përgjithshme dhe objektiva specifike të këtij plani. Objektivi i përgjithshëm është forcimi i integritetit institucional. Objektiva specifike janë forcimi i sistemit të integritetit institucional, identifikimi dhe menaxhimi i rrjedhjeve të integritetit, rritja e transparencës dhe llogaridhënies nga Bashkia, përmirësimi i etikës dhe profesionalizmit në administratë, forcimi i kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, parandalimi i konfliktit të interesit, rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun në proceset e konsultimit publik, monitorimi, vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të integritetit. Këto janë fushat kryesore të cilat e gjeti të arsyeshme grupi i punës që kishte një risk institucional. Fusha: administrimi i burimeve njerëzore, prokurimeve publike, planifikimi urban, menaxhimi dhe administrimi i pronës, përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar, dhënia e lejeve, licencave, autorizimeve dhe akteve administrative, menaxhimi i të ardhurave. Cila ishte metodologjia që përdori grupi i punës për të arritur në evidentimin e risqeve? Hartimi i planit të integritetit është mbështetur në një proces metodologjik të strukturuar, sistematik dhe gjithëpërfshirës, me synimin: identifikimin, analizimin dhe menaxhimin e risqeve. Metodologjia e ndjekur mbështetet në një qasje ciklike dhe parandaluese, e cila fillon me organizimin e procesit të hartimit të planit, vijon me mbledhjen dhe analizimin e



informacionit, identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, përcaktimin e masave parandaluese, dhe përfundon me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të integritetit.

Z.Melsi Bogdani

Eleni, është shumë material i bollshëm, edhe unë do të doja që, në qoftë se kanë ndonjë paqartësi ose ndonjë pyetje konkrete, këshilltarët do ta drejtojnë. Mqs materiali është i jashtëzakonshëm, edhe për t'u kaluar i gjithë këtu se si është punuar dhe se si është bërë, do të duam shumë kohë. Kështu që, më mirë të pyesim këshilltarët nëse kanë ndonjë pyetje, ndonjë paqartësi konkrete dhe ku do paraqitet, pse është kjo emergjencë dhe pse duhet kaluar me kaq ngut. Pastaj, pjesa tjetër, në qoftë se janë të qartë, nuk kemi pse e lexojmë të gjithë materialin, sepse ne e kemi marrë informacionin në këtë rast. Ka ndokush nga këshilltarët ndonjë pyetje konkrete? Ilia, inxhinieri, drejtoi pyetjen që pse është e domosdoshme që ky plan të kalojë tani, kur ne në 2000... në vitin e ardhshëm do të hyjmë në zgjedhje.

Znj.Eleni Gjikonaj

Në fakt, është për herë të parë që përgatitet plani i integritetit. S'ka mundur, domethënë, ndër vite që të përgatitet, por është një gjë për të rritur performancën e secilit nga neve: evidentojmë risqet dhe ne përmirësojmë punën. Është, domethënë, për tu falënderuar të gjithë drejtorët, përgjegjësat, dhe të gjithë ata që kanë bashkëvepruar me neve për të identifikuar risqet e secilit dhe secilën drejtor që të përmirësohet puna. Kjo është një arritje për Bashkinë e Fierit dhe ne performojmë sa më mirë në këtë kuadër. Shikojmë gabimet tona, ku i kemi dhe i përmirësojmë. Nuk lejojmë që, domethënë, i kemi identifikuar disa risqe dhe nuk lejojmë që të ndodhin në të ardhmen. E gjithë kjo është për përmirësimin e punës dhe për performancën sa më të mirë tonën.

Z.Melsi Bogdani

Ok. Ka pyetje tjetër? Po, Marjus?

Z.Marjus Voja

Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Në emër të grupit, ne e mbështesim këtë projektvendim, pasi është një instrument i rëndësishëm për forcimin e transparencës dhe integritetit të bashkisë. Megjithatë, vetë dokumenti evidenton disa problematika që kërkojnë vëmendje, si njohja e ulët e regjistrimit të risqeve të integritetit, njohja jo e plotë e procedurave për administrimin e dhuratave, si njohje jo e plotë e mekanizmit të sinjalizimit, si dhe nevoja për më shumë transparencë në prokurime dhe menaxhimin e pronës. Në këtë kuadër, vlerësojmë si të rëndësishëm edhe raportimi 6-mujor përpara këshillit bashkiak, i cili nuk duhet të jetë thjesht një detyrim formal, por një proces llogaridhënie i shoqëruar me shpjegues konkret mbi masat e zbatuara, problematikën e hasura, rezultatet e arritura dhe masat korrigjuese të ndërmarra. Vetëm në këtë mënyrë këshilli bashkiak mund të ushtrojë në mënyrë efektive rolin e tij mbikëqyrës. Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Ka ndonjë merak tjetër nga këshilltarët? E hedhim në votë: kush është dakord me projektvendimin Nr. 70 "Për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Fier për periudhën 2026-2029? 26 vota pro, 2 abstenime, miratohet.

Pro 26 vota.



Kundra s'ka.

Abstenim 2 vota.

Miratohet.

Pika e pestë e rendit të ditës.

Projektvendim Nr. 69, datë 10.07.2026 ” Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve 2026-2036 të Bashkisë Fier.

Z.Melsi Bogdani

Kush do të relatojë për këtë plan?

Z.Erald Qirjo

Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Në lidhje me ekonominë pyjore Vajkan-Libofsh, është një ekonomi pyjore me një sipërfaqe prej 88.8 hektar. Tashmë, pyjet në Republikën e Shqipërisë janë bërë pjesë e sistemit të ALFIS, dhe për këtë ne do të bëjmë miratimin e mbarështimit të pyjeve. Është ngritur urdhëri i kryetarit, është bërë dixhitalizimi i gjithë sipërfaqes së ekonomisë pyjore. Janë bërë edhe dëgjuesat publike me qytetarët në lidhje me menaxhimin e kësaj sipërfaqe. Kryesisht, te pjesa e mbarështimit të pyjeve është përfshirë ripyllëzime të reja, pasi kemi dëmtime të sipërfaqes së kësaj ekonomie. Kemi edhe një pjesë e cila është dëmtuar nga erozioni i tokës, siç ndodhet në pjesën e Vajkanit të ish-poligoni të qitjes. Pa miratimin e këtij plani, ne nuk mund të vazhdojmë procedurat e mëtejshme në lidhje me ripyllëzimet apo punimet e mëtejshme që mund të bëjmë. Në qoftë se keni ndonjë pyetje, vazhdojmë.

Z.Melsi Bogdani

Kush ka ndonjë diçka, ndonjë merak? Inxhinier, ju si i fushës, keni ndonjë merak?

Z.Erald Qirjo

Më falni, janë edhe të miratuara nëpërmjet Ministrisë. Plani i mbarështimit është bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit. Kaq kisha.

Z.Melsi Bogdani

Kush ka ndonjë merak, ndonjë pyetje për këtë pikë? Nuk ka. E hedhim në votë: kush është dakord për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve 2026-2036 të Bashkisë Fier? Dakord të gjithë, kundër askush, miratohet.


Pro 29 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.



Informacion mbi raportin e performancës së Bashkisë Fier.

Z.Melsi Bogdani

Ky është thjesht informacion.

Znj.Eleni Gjikonaj

Është informacion, por në rast se keni ndonjë pyetje, ose mund t'ju jap të dhëna për secilën fushë informacioni, në qoftë se keni nevojë.

Z.Melsi Bogdani

Për nën... ky është thjesht informacion, nuk duhet të kalojë në votim. Mund të kalojmë më tej?

Kush ka ndonjë merak në lidhje me informacionin? Nuk ka. Atëherë, kalojmë tek pika 7.

Pika shtesë e rendit të ditës.

Pika jashtë radhe: "Për shpërblimin e ekipit të vajzave të FK Apolonisë që militon në Champions League".

Znj.Eleni Gjikonaj

Vlerë, ju lutem vini vlerë.

Z.Melsi Bogdani

Nënkryetar, një vlerë, të lutem, për projektvendimi.

Z.Nustret Avdullaj

20. 000 euro

Z.Melsi Bogdani

Pra, është vlera 20. 000 euro. Po, inxhinier, më thuaj.

Z.Iliria Fili

Po, unë mendoj që ne si këshill mgjth e kanë ngritur kolegët e mi edhe dy herë më para, në dy mbledhjet e mëparëshme, ne duhet të na vijë, për analizë këtu, ekipi i futbollit.

Z.Melsi Bogdani

E kemi kërkuar, e kemi kërkuar me ngulm.

Z.Iliria Fili

Ndërsa për vajzat, jemi me të dyja duart, po.

Z.Melsi Bogdani



E kemi kërkuar, inxhinier. Shumë faleminderit. Kush është dakord për shpërblimin 20.000 euro të ekipit të vajzave?

Znj. Antoneta Çunaj

E ka fondin bashkia?

Z. Melsi Bogdani

Të gjithë po. Të gjithë dakord? Miratohet.

Pro 29 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z. Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Takohemi në mbledhjen e radhës të këshillit, që është më datë 31, ditën e premte, ora 11:00. Shumë.

Shënim: Në përfundim të mbledhjes, sekretarit të këshillit ju komunikua nga Z. Ilia Fili pamundësia e firmosjes së procesverbalit të mbledhjes nga ana e tij dhe në këto kushte pasi u kontaktua krietari i grupit të PD-së ku bën pjesë këshilltari Z. Ilia Fili, Z. Rrapi Gjika u ra dakort me këtë të fundit që firmosja e procesverbalit do të kryhej nga vetë Z. Rrapi Gjika. Për këtë ndryshim u vë në dijeni edhe Kryetari i Këshillit Z. Melsi Bogdani.

Ky procesverbal ka 9 (nëntë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Çupa

Kryetar i Këshillit

Melsi Bogdani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 9617/2 Prot

Fier më, 31.07/2026

PROCESVERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 31.07.2026. Sot në sallën e mbledhjeve ora 11:00. Të pranishëm në mbledhje 34 këshilltarë.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Ndjesë për vonesën e vogël. Në bazë të njoftimit të datës 23/07/2026, me Nr. Protokolli 9617, zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Fier. Para se të fillojmë të hedhim në votë rendin e ditës, bëjmë zgjedhjen e 3 anëtarëve të këshillit për firmosjen e procesverbalit të mbledhjes. Marius, propozim për 1 anëtar për firmosjen e procesverbalit?

Z.Marjus Voja

Unë.

Z.Melsi Bogdani

Marius Voja. Niku?

Z.Kreshnik Dapi

Vetë.

Z.Melsi Bogdani

Rrapi mungon.

Z.Ilia Fili

Rrapi Gjika

Z.Melsi Bogdani

Rrapi? Rrapi Gjika. Dakord? Atëherë, në mbështetje të nenit 53 pika 4 dhe nenit 56 pika 2, shkronja a), Ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen Vendore i ndryshuar", dhe "Rregullores së Këshillit

Bashkiak” neni 61, si dhe kërkesës për mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Kryetarit të Bashkisë me numër 8999 protokoll, datë 09. 07. 2026, njoftojmë thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të radhës në seancën plenare, ditën e premte, datë 31/07/2026, në orën 11:00. Rendin e ditës e keni të mos e lexoj.

Z.Marjus Voja

Jo, vazhdoni.

Z. Melsi Bogdani

Ke diçka në lidhje me rendin e ditës para se të hedhim votim? Po, Ilia.

Z.Ilia Fili

Po. Zoti Kryetar, ne kemi rënë dakord që në çdo mbledhje të këshillit të ketë një pikë, ku anëtarët e këshillit, të ngrenë sugjerimet dhe kërkesat nga zonat ku jetojmë dhe ku punojmë. Në këtë rast, unë s'e shoh që është listë, por keni bërë mirë që s'e keni vënë, sepse edhe kur kemi shtruar problemet, me seriozitet të plotë deklaroj që absolutisht bashkia nuk e vë ujën në zjarr. Asnjë lloj korrigjimi, asnjë lloj veprimi në lidhje me të tërë sugjerimet dhe propozimet që kemi sjellë ne. Edhe një herë po rikujtoj edhe një gjë: unë e shoh domosdoshmërisht këtë muaj që është piku i lëvizjeve në Fier. Kemi 2 vjet që kemi miratuar semaforët, në çdo mbledhje kemi semaforët, semaforët. Absolutisht nuk shoh asnjë lloj veprimi. Duam sqarime, ku ka ngecur kjo pikë nga bashkia? Sepse është një miratim nga ne. Në rast se ky nuk zbatohet, do të thotë që bashkia nuk përfill mendimin e Këshillit Bashkiak.

Z.Melsi Bogdani

Inxhinier shumë faleminderit. Ju ishit në mungesë. Ne i kërkuam ekzekutivit sqarim për të gjitha pikat e ngritura nga këshilltarët, dhe nga ekzekutivi kemi marrë përgjigje, që do të na vijnë të gjitha pikat me shkrim. Por fakti që kjo mbledhje ishte pak e ngarkuar nga pikat e rendit të ditës, si kryesi, vendosëm që këtë pikë ta anashkalojmë vetëm për këtë mbledhje të këshillit. Kështu që, në mbledhjen e ardhshme të këshillit, të gjitha pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga këshilltarët, ekzekutivi do t'i ketë gati përgjigjet.

Z.Ilia Fili

Shiko, unë nuk dua përgjigje nga bashkia në këshill. Unë dua përgjigje në veprimin në terren. Mua më mjafton veprimi në terren. Po s'më veprohet në terren, mua s'më intereson fare...

Z.Melsi Bogdani

Shumë...

Z.Ilia Fili

Nëse vjen bashkia në këshill apo jo!

2



Z.Melsi Bogdani

Ok.Shumë faleminderit. Po, Marius?

Z.Marjus Voja

Përpara se të miratojmë rendin e ditës, kam një propozim në emër të grupit që pikën 4 ta heqim nga rendi i ditës, pasi mbështesim qëndrimin e Komisionit të Ekonomisë, i cili është dakord që në parim kjo hapësirë të zhvillohet nga privati, por ne nuk mund të japim një miratim përfundimtar pa pasur një projektvendim të plotë dhe një relacion të detajuar për të përcaktuar qartë kushtet, kriteret, detyrimet e palëve, mënyra e menaxhimit, standardet e mirëmbajtjes. Gjithashtu, të përcaktohen edhe pikat dhe koordinatat ku do të jepet kjo hapësirë. Gjithashtu, nga përvoja e deritanishme, ka rezultuar që mirëmbajtja nuk ka qenë në nivelin e duhur. Për këtë arsye, ne propozojmë që, në kontratë të përfshihet një mekanizëm i detyrueshëm monitorimi çdo 3 muaj nga një grup pune i ngritur nga bashkia. Në rast të moszbatimit të detyrimeve kontraktore, shkelja e parë të ndërkohet me penaltet financiar. Në rast të përsëritjes së shkeljes, të përcaktohet një klauzolë për zgjidhjen e kontratës.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Atëherë, e hedhim rendin e ditës në votë pa pikën 4. Kush është dakord? Të gjithë dakord? Miratohet. 33 është numri?


Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kalojmë në miratimin e rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 22.06.2026.
3. Projek-vendim Nr.73 datë 20.07.2026 "Për pranimin në shtëpinë e të moshuarve"
4. Projekt- vendim Nr.53. datë 22.05.2026 "Për dhënien e mendimit/ dakordësimi në parim mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapësirës publike. pasuria nr.3/339, zk. 8534 (ulishte), me sipërfaqe taotale 3702 m2, lagja Apollonia' Fier, në pronësi të Bashkisë Fier.
5. Projek-vendim Nr.54, datë 22.05.2026 "Për miratimin e kërkesës së shoqërisë 'Enterprises Albania' shpk për dhënien e së drejtës për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore, sipas kontratës



nr. 1224 rep., nr.562 kol. datë 18.09.2024, nga shoqëria 'Enterprises Albania' sh.p.k tek shoqëria Gloë Solar sh.p.k.(SPV)"

6. Projekt - vendim Nr. 68 datë 10.07.2026 "Për miratimin e projektit 'Rikonstruksion i rugës 'Aulona', segmenti nga rethrotiulli i QTU-së deri tek kthesa e Azotikut".

7. Projekt-vendim Nr. 62 datë 17.06.2026 "Për miratimin në parim të vend-depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Fier"

8 Projekt -vendim Nr. 67 datë 10.07.2026 « Për një shtesë dhe ndryshim në Vendimin e Këshillit 1# Bashkisë me Nr.63 datë 23.06.2025. nr.733 1/2 prot datë 25.06.2025 "Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik . për pasuritë e paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit" vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier . për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik".

9. Projekt-vendim Nr.72 datë 14.07.2026 " Për përcaktimin e fornës së kalimit të kontributit prej 3% të sipërfaqjes ndërtimore për fondin publik të banesave sociale, nga subjekti Ndreu Konstruksion SH:P:K., në sipërfagje ndërtimi (metër katror) ose në vlerën monetare (lekë).

10.Projekt-vendim Nr.74 datë 22.07.2026 "Për miratimin e Tavanëve Përfundimtare(pandryshuar) të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm 2027-2029" të Bashkisë Fier.

11. Projek-vendim Nr.52 datë 18.05.2026 "Pë disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.109 datë 27.11.2025 Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026.

12. Projek-vendim Nr.75 datë 23.07.2026 "Për një ndryshim (shtesë fondesh) në VKB Nr. 118. dt 11.12.2025 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028 përfundimtar dhe miratimin e buxhetit të vitit 2026" i ndryshuar".

13. Projek-vendim Nr.76 datë 23.07.2026 "Per përcaktimin dhe miratimin e kriterëve, vlerës dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë familjet në nevojë që kërkojnë të trajtohen me ndihmë të menjëhershme financiare"

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, e hedhim rendin e ditës në votë pa pikën 4. Kush është dakord? Të gjithë dakord? Miratohet.
33 është numri?

Z.Arnando Çupa

33.

Pro 34 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Ok. Shumë faleminderit. Kalojmë në pikën 2.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 22.0. 2026.

Z.Melsi Bogdani

Sekretar?

Z.Arnando Çupa

Atëherë, procesverbali si zakonisht ju është bërë i ditur me emailin, ju është dërguar, siç është praktikë tashmë standarde prej 3 vjetësh të kryetarëve të grupeve edhe personave të cilët janë caktuar nga ana juaj për ta firmosur. Nga ana e tyre është konstatuar pa probleme, është firmosur dhe është depozituar sipas rregullit në protokoll.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. E hedhim në votë miratimin e procesverbalit. Kush është dakord? 32 vota pro, 1 abstenim. Miratohet.

Pro 32 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.



Z.Melsi Bogdani

Kalojmë në pikën 3

Pika e tretë e rendit të ditës.

Projektvendim nr. 73, datë 20/07/2026, për miratimin në shtëpinë e të moshuarve.

Z.Melsi Bogdani

Të miratojë kërkesën Florentina Miti Tavanxhiu, e datëlindjes 15. 08. 1943, lindur në Fier dhe banues në Fier. Ka ndonjë merak nga këshilltarët? E hedhim në votë. Kush është dakord? Të gjithë dakord? Kundra? S'ka? Abstenim? S'ka? Miratohet.

Pro 34 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projektvendim Nr.53. datë 22.05.2026 "Për dhënien e mendimit/ dakordësimin në parim mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapsirës publike. pasuria nr.3/339, zk. 8534 (ulishte), me sipërfaqe taotale 3702 m2, lagja Apollonia' Fier, në pronësi të Bashkisë Fier.

Z.Melsi Bogdani

Sikurse u tha më lartë pika katër, me propozim të kryetarit të grupit të këshilltarëve të PS-së tërhiqet nga rendi i ditës. Kalojmë në pikën 5

Pika e pestë e rendit të ditës.

Projek-vendim Nr.54, datë 22.05.2026 "Për miratimin e kërkesës së shoqërisë 'Enterprises Albania' shpk për dhënien e së drejtës për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore, sipas kontratës nr. 1224 rep., nr.562 kol. datë 18.09.2024, nga shoqëria 'Enterprises Albania' sh.p.k tek shoqëria Gloë Solar sh.p.k.(SPV)"

Z.Melsi Bogdani

Komisioni i Ekonomisë është mbledhur për këtë pjesë?

6

Znj.Erlinda Llupi

Përsëritje. Po, Komisioni i Ekonomisë u mbledh ditën e djeshme dhe vendosi sa ta kalojë për miratim në këshill.

Z. Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Ka ndonjë merak nga këshilltarët? Atëherë, e hedhim në votë. Kush është dakord për kalimin? Kundra? S'ka? Miratohet.

Pro 34 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projektvendim Nr. 68 datë 10.07.2026 "Për miratimin e projektit 'Rikonstruksion i rrugës 'Aulona', segmenti nga rrethrotullimi i QTU-së deri tek kthesa e Azotikut".

Z. Melsi Bogdani

Materialet ju kanë ardhur. Ekzekutivi na thotë ndonjë fjalë mbi projektin, shkurtimisht.

Z.Mariglen Hoxhaj

Përsëritje të gjithëve! Ashtu siç jeni vënë në dijeni për pikën 6, për projektvendimin për rikonstruksionin e rrugës Aurona, bëhet fjalë për rrugën, segmentin rrugor nga rrethrotullimi i QTU-së deri te kthesa e Azotikut. Shpresojmë detajet teknike të projektit, relacionet dhe të gjitha të jenë shpjeguar nga ekzekutivi. Jo më larg se dje ishim në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë, ku i pamë me detaje të gjitha dhe, nëse keni ndonjë pyetje, ndonjë paqartësi, mund të...

Z.Melsi Bogdani


Shumë faleminderit, zoti Nënkrjetar. Komisioni u mbledh? Komisioni?

Z.Flori Lika

Po.

Z.Melsi Bogdani

Po?



Z.Flori Lika

Dita e djeshme është e mbledhur Komisionit i Investimeve Publike. Pas diskutimeve, u vendos që kjo pikë të kalojë për miratim.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Ka ndonjë merak nga këshilltarët në lidhje me këtë investim?

Znj.Suzana Numani

Ne jemi shumë dakord, biles është e vonuar,duhet të kishte filluar... është hyrja kryesore ose dalja e Fierit...kështu që sa më shpejt duhet të mbarojë të bëhet.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Po ka ndonjë merak tjetër? E hedhim në votim. Kush është dakord për pikën 6, miratimin e projektit "Rikonstruksioni I rrugës Aurona", segmenti nga rrethrrrotullimi I QTU-së deri te kthesa e Azotikut? Të gjithë dakord? Kundra? S'ka? Abstenim? S'ka? Miratohet.

Pro 34 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Kalojmë në pikën 7.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

Projekt-vendim Nr. 62 datë 17.06.2026 "Për miratimin në parim të vend-depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte në territorin e Bashkisë Fier"

Z.Melsi Bogdani

Dy fjalë nga ekzekutivi?

Z.Erald Qirjo

Atëherë, përshëndetje të gjithëve. Në lidhje me pikën nr. 7, projektvendimi për miratimin e vendit depozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte, bashkia Fier ka bërë një studim dhe ka përcaktuar 3 vende depozitime. Një ndodhet në fshatin Grykë në Topojë, e cila është një pasuri shtetërore, është moçal, është tokë pa frut, në të cilën është menduar të depozitohen dherat e buta nga gërmimet, që



dalin nga punimet e ndryshme që kryhen nga subjektet , apo qoftë edhe nga bashkia. Dy pika të tjera të miratuara do të jenë edhe pika e Azotikut, ku kemi pikën e mbledhjeve të urbane, në të cilën kemi menduar që të hedhim mbledhje inerte që janë, që dalin nga punimet që bëhen nëpër shtëpia, apo nga prishjet e ndryshme. Inertet e holla, të cilat më pas do të shfrytëzohen për shtrimin e rrugëve të parcelave, në të cilën do të marrin edhe një pajisje për përpunimin e këtyre mbledhjeve të buta. Një pikë e tretë është në Metalli, mbrapa tek fabrika e tullave, e cila është një sipërfaqe toke private, në të cilën vetë subjekti privat ka paraqitur interesin edhe te inertet e trasha. Inertet e trasha bëhet fjalë për copëzat e betonit të mëdha, e cila nuk mund të përpunohet në ato makineri për t'i kthyer, që ne t'i shfrytëzojmë ato në lidhje me shtrimin e rrugëve të parcelave apo të fshatrave etje. Subjekti ka bërë edhe një kontratë noteriale me bashkinë e Fierit, në të cilën ka rënë dakord që të bëhen depozitime.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit, zoti Nënkyetar. Komisioni u mbledh për këtë pikë?

Z.Erald Qirjo

Edhe një fjalë të fundit. Ato pika, janë të përkohëshme që do të thotë mund të zgjasin 1 muaj, mund të zgjasin edhe 6 muaj. Pasi AKEM-i Agjencia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve, nga janari ka filluar punën, deri në marrjen e dorëzimit të landfillit të bashkisë.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Komisioni? Po?

Z.Flori Lika

Ditën e djeshme u mbledh komisioni dhe, pas diskutimeve dhe pa ndonjë konfliktit, u kalua për miratim në këshill.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Ka ndonjë merak nga...Po.

Z.Marjus Voja

Jemi dakord për përcaktimin e këtij vendi depozitimi, por do t'i lëmë një detyrë ekzekutivit, të rishikojë dhe korrigjojë relacionin e vlerësimit mjedisor, pasi në dokumentacion ka pasaktësi. Në relacion, në fshatin Grykë, duhen mbetje të buta dhe dhera, dhe jo mbetje nga prishja e objekteve ose ndërtimi nga makineritë .Eraldi është në dijeni, duhet ta korrigjojë.

Z.Erald Qirjo

Për këtë ke të drejtë, është thjesht një gabim është një lapsus te relacioni që është bërë te VNM-ja Pas miratimit të...që do bëhet këtu në këshill, do ti përcillet Ministrisë së Mjedisit për miratimin përfundimtar. Atje do ta korrigjojmë

Z.Melsi Bogdani

Ok. Shumë faleminderit. Ka ndonjë merak tjetër? Po, Kristian.

Z.Kristian Kina

Përsëritje! Më bëri përshtypje një diçka që një kompani private dhe bujrum, në fakt, ajo që shprehu kërkesën, por që momenti i shprehjes së kërkesës nga ana e saj ka ardhur pasi është bërë një kërkesë publike nga ana e bashkisë, apo...pra, si ajo ka shprehur kërkesën? Sepse mos të bëjmë mbase në mënyrë selektive, se mbase, le të themi, që është kanë bërë bujarë dhe kompanitë e tjera dhe mbase s'ka pasur mundësi, ose...e para, dhe e dyta, pas një apo 6 muajsh, që është me të vërtetë specifikim i duhur nga ana jote në fund, është ekzekutivi i bashkisë i cili do të...do të shikojë përsëri këto mbetjet e para, le të themi, që a janë... a është sasia e duhur ose e saktë, ajo e caktuar, ajo që është dhënë dhe ajo që është marrë, apo ka ndonjë ndryshim, le të themi, e kupton çfarë dua të them?

Z.Erald Qirjo

Në lidhje , mbasi AKEM-i të marri në dorëzim landfillin e Fierit, për të cilin jemi në fazën e korrespondencës së dokumentave. Këto pika do të sigurojnë që të kenë plan rilevimi, qoftë për mbetjet inerte, qoftë edhe për mbetjet e dheut. Kështu që këto pika do jenë bosh. Janë provizore.

Z.Kristian Kina

Dhe këtë e kuptova, por pyetja tjetër, e para...

Z.Erald Qirjo

Pyetja tjetër është subjekti privat. Subjekti privat ka një tokë pa frut të cilën ka vite që e shfrytëzon, në qoftë se keni parë, ajo është një tokë shumë e madhe.

Z.Kristian Kina

Po si e shprehu kërkesën e kisha fjalën ? Pra...


Z.Erald Qirjo

Ka shprehur interesin e vet...


Z.Kristian Kina

Kur? Pse?

Z.Erald Qirjo



10



Ka shprehur interesin e vet nëse keni mbetje thotë, inerte të ndryshme, mund t'i depozitoni në tokën time.

Z.Kristian Kina

Jo, mendoj se do ishte më korrekt nga ana e bashkisë që do kishte bërë një shpjegim dhe ti kishte kthyer një përgjigje kërkesës

Z.Erald Qirjo

Janë bërë dëgjesat publike.

Z.Kristian Kina

Pra, një...pra, e kupton çfarë dua të them? Ideja që mbase ka kompani të tjera, le të themi, 2, 3, 5, të tjera që mund të kenë kërkesë dhe dëshirë, por që s'kanë parë kërkesën publike nga ana e bashkisë, prandaj po pyes që mos... mos të bëhet selektive, le të themi, që nesër pasnesër të mos të ketë pretendime.

Z.Erald Qirjo

Dëgjesa ka qenë publike, ka qenë e publikuar edhe në ueb dhe nuk ka pasur interes nga ana e askujt.

Z.Kristian Kina

Ok, ka qenë ueb, kaq doja.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Po, Niku.

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë, përshëndetje! Në vijim të bashkëbisedimit me kolegun, në dijeninë tonë si Kryesi e Këshillit, nuk ka deri tani kërkesë tjetër përveç subjektit AEO SHA. Kjo është një përputhje interesash, sepse subjekti ka një tokë e cila, për arsye ndërtimore, kërkon rilevim edhe mbushje, dhe në kuadër vetë të interesit të tij, por edhe interesit të përbashkët të bashkisë për të çuar, depozituar këto mbetjet e buta inerte diku, ai ka bërë një kërkesë për hirë të së vërtetës ka 2 vjet që e ka bërë këtë kërkesë. Ka këmbëngulur dhe ka insistuar që ajo të trajtohet. Mua më vjen mirë që më në fund administrata e mori parasysh. Gjithashtu, shtoi edhe dy pika të tjera të cilat kanë të njëjtën problem teknik si toka ose pasuria në fjalë e biznesit privat, dhe vijnë me këtë projektvendim të cilin ne si komision e shqyrtuam në detaj dhe ju propozojmë ta miratojmë.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit, Niku! Atëherë, ka ndonjë merak tjetër para se ta hedhim në votë? E hedhim në votë projektvendim nr. 62 për miratimin në parim të vendit depozitimeve të përkohshme të mbetjeve

inerte në territorin e Bashkisë Fier. Kush është dakord? Kundra? Atëherë, 31 vota pro, 2 abstenim, miratohet.

Z.Armando Çupa

Kryetar, janë 34.

Z.Melsi Bogdani

Iku Neta, janë 33.Nuk gaboj me numrat.

Z.Armando Çupa

Dakort.

Pro 31 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim 2 vota.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kalojmë në pikën 8

Pika e tetë e rendit të ditës.

Projektvendim Nr. 67 datë 10.07.2026 « Për një shtesë dhe ndryshim në Vendimin e Këshillit 1# Bashkisë me Nr.63 datë 23.06.2025. nr.733 1/2 prot datë 25.06.2025 "Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik . për pasuritë e paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit" vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier . për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik".

Z.Melsi Bogdani

Ka ndonjë? Komisioni u mbledh për këtë pjesë. Ka ndonjë merak?

Znj.Erlinda Llupi

Komisioni u mbledh dhe vendosi ta kalojë për miratim.

Z.Melsi Bogdani

Ndonjë merak tjetër ka? Kush është dakord? Po, po.

Z.Ramadan Mehmetaj

Doja të dija, i njëjti projekt që kemi kaluar këtu në 2025, apo ka ndryshim të variantit?

Z.Melsi Bogdani

Është i njëjti projekt, ta thotë edhe këtu në...

Znj.Erlinda Llupi

Është i njëjti projekt.

Z.Melsi Bogdani

Mariglen, është i njëjti projekt, ka ndryshim të projektit në variantin 2025?

Z.Mariglen Hoxhaj

Jo sipas gjurmës...

Z.Erald Qirjo

Është i njëjti projekt, me atë të vitit të kaluar. Është vetëm një banesë që afrohet pak tek terminali..
vetëm për këtë është studimi.

Z.Mariglen Hoxhaj

Ajo është...Është shumë pak, as 1 metër, nuk është edhe 1 metër.

Z.Erald Qirjo

As 1 metër në krahasim me projektin e mëparshëm.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Po, zysha?

Z.Ramadan Mehmetaj

Kryetar, vetëm për tek shtëpia apo edhe...

Z.Erald Qirjo

Vetëm tek banesa. Është një banesë të cilës rruga i vinte tek dritaret e shtëpisë.

Z.Melsi Bogdani

Po Yllka

Znj.Yllka Sheshi

Pronarët e asaj banese janë dakord me shpronësimin që po i bën bashkia?

Z.Erald Qirjo

Po, ka qenë kërkesa e tyre për shpronësim. Dhe ajo tokë që u përdor është tokë e tyre.

Znj.Yllka Sheshi

Sepse lindin probleme, që shpronësimi është një vlerë monetare aq e vogël në krahasim me atë shpenzim që banori mund të ketë bërë në banesën e vet.

Z.Erald Qirjo

Nuk është banesa që shpronësohet, është një sipërfaqe toke bujqësore.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, e hedhim në votë. Kush është dakord me pikën 8? Dakord? Abstenim? 1? Miratohet. 32 vota pro.

Pro 32 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani



Atëherë, kalojmë në pikën 9

Pika e nëntë e rendit të ditës.

Projektvendim Nr.72 datë 14.07.2026 " Për përcaktimin e fornës së kalimit të kontributit prej 3% të sipërfaqjes ndërtimore për fondin publik të banesave sociale, nga subjekti Ndreu Konstruksion SH:P:K., në sipërfagje ndërtimi (metër katror) ose në vlerën monetare (lekë).

Z.Melsi Bogdani

Komisioni u mbledh për këtë punë?

Znj.Erlinda Llupi

Po. Gjatë shqyrtimit të projektvendimit, komisioni konstatoi pasaktësi në mënyrën e përlogaritjes së çmimit dhe parashikimin e pagesës me këste, e cila nuk ishte në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këtë gjetje iu bë me dije administratës, e cila reflektoi vërejtjet e komisionit për korrigjimet përkatëse dhe paraqiti sërish projektvendimin me dokumentacionin e përditësuar. Pas shqyrtimit të materialit të rishikuar, komisioni vendosi se vërejtjet e ngritura ishin adresuar dhe propozoi miratimin e projektvendimit me atë shqyrtim.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Ndonjë merak tjetër nga këshilltarët? Ndonjë pyetje për këtë pikë? E hedhim në votë pikën 9. Kush është dakord? 31 pro, 2 abstenim, miratohet.

Pro 31 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim 2 vota.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kalojmë në pikën 10

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim Nr.74 datë 22.07.2026 "Për miratimin e Tavanëve Përfundimtare(pandryshuar) të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm 2027-2029" të Bashkisë Fier.

Z.Melsi Bogdani

Për të mos relatuar, që të mos lëvizi Pranvera, keni ndonjë...kush ka ndonjë merak, ndonjë pyetje? Komisioni? Po, tavanet janë...

Znj.Erlinda Llupi

Komisioni vendosi ta kalojë për miratim në këshill.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Ndonjë merak nga këshilltarët? Nuk ka. E hedhim në votë. Kush është dakord me miratimin e tavanëve përfundimtare? Kundra? Atëherë, 3 kundra, 3 abstenim, 27 vota pro. Miratohet.

Pro 27 vota.

Kundra 3 vota.

Abstenim 3 vota.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kalojmë në pikën 11

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim Nr.52 datë 18.05.2026 "Pë disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.109 datë 27.11.2025 Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026

Z.Melsi Bogdani

Ky projektvendim ishte ai që i tërhoqëm më parë për t'i dhënë kryetarit dhe morëm dakordësinë edhe nga ekzekutivi. Kush ka ndonjë pyetje, ndonjë merak, para se ta hedhim në votë? Jeni dakord me projektvendimin nr. 52 për disa... Marjus kishte diçka?

Z.Marjus Voja

Po, kisha.

Z.Melsi Bogdani

Po, më thuaj, para se ta hedhim në votë.

Z.Marjus Voja



Mbështesim uljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sepse besojmë se është një masë që mund të nxisë investime të tjerë. Prej 12 vjetësh, qyteti nuk ka pasur ndërtime dhe është e qartë që duhen politika që krijojnë shumë lehtësi për investitorët. Qëllimi nuk është të favorizojmë ndërtuesit, por të krijojmë kushte që të rikthehen investitorët, të hapen vende pune dhe të zhvillohet ekonomia e qytetit.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Po, Niku?

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë, gjej rastin që ti kërkoj administratës së bashkisë mqs jemi në prag të rifillimit të procedurave për paketën fiskale dhe buxhetin e vitit 2027, të ftojë dhe këshillin, ose kryetarët e grupeve, ose anëtarët e kryesisë, të jenë qoftë edhe pjesëmarrës pa të drejtë vendimi dhe vote, që vitin e ardhshëm ne të dalim me një paketë fiskale dhe me një buxhet konsensual dhe të pranuar, gjithëpërfshirës, të pranuar nga gjithë qytetarët dhe subjektet. E mbështesim nismën, është shumë e dobishme, biles është e vonuar.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Kush është dakord? 32 vota pro, 1 abstenim, miratohet.

Pro 32 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kalojmë në pikën 12

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekvendim Nr.75 datë 23.07.2026 "Për një ndryshim (shtesë fondesh) në VKB Nr. 118. dt 11.12.2025 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028 përfundimtar dhe miratimin e buxhetit të vitit 2026" i ndryshuar".

Z.Melsi Bogdani

Po, pranvera? Do vish në mikrofon, të lutem. Hajde këtu.

Znj.Pranvera Cina



Faleminderit! Në vijim të procesit të menaxhimit financiar dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2026, nëpërmjet këtij projektvendimi propozojmë shtimin e buxhetit të Bashkisë Fier në një vlerë totale prej 6. 468. 129 lekë, duke e çuar buxhetin e Bashkisë Fier në vlerën 8. 963. 254. 645 lekë. Ky propozim vjen si rrjedhojë e ndryshimeve të transfertave nga buxheti i shtetit, bazuar në aktin normativ nr. 2 i datës 30/06/2026. Buxheti që do të shtohet nga transfertat e pa kushtëzuar sektoriale për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, në vlerën 3. 200. 000 lekë, propozohet të akordohet për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, po ashtu në fond sektorial. Duke konsideruar rëndësinë e këtij shërbimi për sigurinë e qytetarëve dhe territorit, propozohet që ky fond të alokohet për shpenzime të tjera.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Shumë faleminderit. Ka ndonjë merak nga këshilltarët për këtë pjesë? Ndonjë pyetje? Komisioni i ekonomisë?

Znj.Erlinda Llupi

Komisioni vendosi ta kalojë për miratim në këshill.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit!Ndonjë merak tjetër nga këshilltarët ka? Kush është dakord për një ndryshim shtesë fondesh? Miratimin e programit buxhetor përfundimtar dhe miratimin e buxhetit? Dakord? Të shikojmë të gjitha këto, të lutem. Atëherë, 3 kundër, 2 abstenim, 28 vota pro, miratohet.

Pro 28 vota.

Kundra 3 vota.

Abstenim 2 vota.

Miratohet.

Z.Marjus Voja

Kryetar, më leje?

Z.Melsi Bogdani

Po?

Z.Marjus Voja

Pa kaluar në pikën tjetër. Mendoj që për projektvendimin nr. 9 duhet të shpreheshim në vlerë monetare ose. ..

Z.Melsi Bogdani



E pra, u shprehëm në vlerë monetare, mgjth korrigjimet që u bënë nga komisioni i Ekonomisë.

Z.Marjus Voja

Korrigjimet u bënë për vlerën monetare që duhet të paguhesh, por ne nuk u shprehëm se projektvendimi thotë në banesë...

Z.Melsi Bogdani

Në lekë, në lekë në vlerë monetare

Z.Esmeralda Kapllanaj

Ideja është që duhet të shpreheni në lidhje me kërkesën e subjektit. Subjekti ka parashtuar një kërkesë duke. ..

Z.Marjus Voja

Që do ta paguajë në lekë.

Z.Esmeralda Kapllanaj

Për shkakun sepse ai ofron atë formë të dhënies së kontributit dhe prandaj edhe u paraqit materiali në Këshillin bashkiak, pas interpretimit ligjor të neneve përkatëse dhe evidentimit të gabimit që ishte bërë nëpër llogaritjen e formës së dhënies së kontributit në vlerë monetare, duhet të shprehet në lidhje me pranimin e kërkesës së subjektit për dhënien e vlerës së kontributit 3% në vlerë monetare dhe jo në fond banesash.

Z.Melsi Bogdani

Pra, në vlerë monetare.

Z.Esmeralda Kapllanaj


Okej, në vlerë monetare.

Z.Melsi Bogdani

Komisioni ekonomik ... në vlerë monetare. Në vlerë monetare ne s'kemi problem.

Z.Marjus Voja

Po, pra, duhet të shprehemi ne.



Z.Melsi Bogdani

Atëherë, ta hedhim edhe njëherë pikën 9?

Z.Kreshnik Dapi

Jo, jo është e qartë.

Z.Marjus Voja

Është e qartë por duhet të caktohet që...

Z.Melsi Bogdani

Ta citoj dhe një herë?

Z.Esmeralda Kapllanaj

Jo ne kishim detyrimin ta qartësonim sepse duhet të vijojnë procedurat e ndryshme administrative. Në rregull? Atëherë, nga këshilli i bashkisë Fier është pranuar kërkesa e subjektit për përlogaritjen e vlerës. ..

Z.Melsi Bogdani

E morëm të mirëqenë, meqenëse komisioni i ekonomisë evidentoi. Prandaj e morëm të mirëqenë në vlerë monetare.

Z.Armando Çupa

Kryetar, më fal?

Z.Melsi Bogdani

Po.

Z.Armando Çupa

Atëherë, siç e vuri në dukje kryetari i grupit socialist, është... kemi të bëjmë me dy momente, korrigjimi ka të bëjë me një gabim që është gjetur në dokument.

Z.Melsi Bogdani

Atë jemi të qartë, jemi të qartë.

Z.Armando Çupa



Pra duhet të shpreheni , që edhe të fiksohet në procesverbal, që këshilli bashkiak miraton midis dy alternativave, miraton propozimin për ta dhënë kontributin në vlerë financiare, që kjo të ngelet në procesverbal.

Z.Melsi Bogdani

Pra, jeni dakord me këtë pjesë? Ka marrë 31 vota pro, 2 abstenim, në vlerë monetare. Dakord të gjithë?

Z.Agron Profka

Dakort.

Z.Kreshnik Dapi

Dakort.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kalojmë në pikën 13

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.

Projektvendim Nr.76 datë 23.07.2026 "Per përcaktimin dhe miratimin e kriterëve, vlerës dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë familjet në nevojë që kërkojnë të trajtohen me ndihmë të menjëhershme financiare"

Z.Melsi Bogdani

Më vjen shumë mirë që më në fund ky komision do të formalizohet në mënyrë perfekte, që më në fund të marrin të gjitha kërkesat e menjëhershme, qoftë për sëmundje, por të marrin të kalojnë në shqyrtim. Kush e do, do ndonjë fjalë nga këshilltarët për këtë pikë?Po Marjus.

Z.Endri Jaupaj

Pësr mua kjo duhet të ishte pika e parë e rendit të ditës Jemi shumë të vonuar. Ju lutem, komisioni të fillojë nga puna.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Po, Marius?

Z.Marjus Voja



Në cilësinë e kryetarit të komisionit që ka hartuar këto kritere duhet të theksojë se qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi i një procedure të qartë, transparente, të barabartë për trajtimin e kërkesave për ndihmë të menjëhershme. Deri më sot, raste të tilla janë trajtuar pa kriteret e miratuara në këshillin bashkiak. Me këtë projektvendim vendosim rregulla të qarta për përfituesit, dokumentacionin që duhet të paraqitet në kufirin maksimal të ndihmës financiare, duke garantuar që fondet publike të shkojnë te familjet që kanë realisht nevojë. Ftoj kolegët që ta miratojnë.

Z.Melsi Bogdani

Ka ndonjë merak tjetër? Jo, e hedhim në votë. Kush është dakord? Të gjithë dakord, miratohet.

Pro 33 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, kush si ka bërë pushimet, i uroj pushime të mbara. Mbledhja e radhës e këshillit bashkiak Fier është e enjtja ose e premtdja e fundit e muajit gusht.

Ky procesverbal ka 22 (njëzet e dy) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Çupa

Kryetar i Këshillit

Melsi Bogdani

